



# Fjala e POLICISE

Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit

Maj 2017  
E përmuajshme  
falas

Adresa:  
Rruga "Çerçiz  
Topulli, Nr. 13,  
Tiranë



BOTIM I SPPSH

www.sindikatapolicise.com

**Gjykata: Kontrata e punës, në fuqi, të zhblokohen kuotizacionet**

Faqe 7

**Sindikata, 17 padi kolektive në gjykatë për policinë**

Faqe 6-7



**Kryesia: Cilat janë 4 shkeljet e Drejtorisë ndaj punonjësve**

Faqe 5

**Pagat e reja për policinë, Fishta: Vendimi i ul deri në 15%**

Faqe 6

## CESP-policisë: Respektioni kontratën, ose në Strasburg!



Drejtuesit e Sindikatës Europiane të Policisë takojnë krerët e policisë në Tiranë. Diskutimi i plotë mes tyre

Faqe 2-3

**B**llokimi që Policia e Shtetit i ka krijuar Sindikatës së Punonjësve të Policisë prej më shumë se tre vitesh ka detyruar drejtuesit e Këshillit të Sindikatave Europiane të Policisë (CESP) që të vijjnë në Shqipëri dhe të organizojnë një takim me drejtuesit e policisë shqiptare. Takimi u organizua në fillim të muajit mars. Gjatë një diskutimi të nxehtë u duk qartë se përfaqësuesit e policisë nuk donin të mbështesnin sindikalizmin dhe nuk kishin dëshirë të respektonin kontratën kolektive të firmosur që në vitin 2009, duke vendosur kushte të reja, edhe pse CESP deklaroi se për mohimin e këtyre të drejtave do të ndjekë të gjithë hapat ligjore, deri në gjykatën e të drejtave të njeriut në Strasburg. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues

të Avokatit të Popullit, të cilët herë pas here kanë dhënë rekomandime për zgjidhjen e këtij ngërçi, por nuk janë marrë parasysh nga Drejtoria e Policisë së Shtetit. Diskutimi i nxehtë, i cili zgjati mbi një orë u përqendrua kryesisht te bllokimi që policia i ka bërë sindikatës, duke u bazuar në tre shtylla kryesore, largimi i saj nga zyrat sipas kontratës kolektive, heqja nga puna ose transferimi i drejtuesve sindikalë, pa u konsultuar më parë me sindikatën dhe bllokimi i kuotizacioneve të derdhura nga punonjësit e policisë, veprim i ndërmarrë nga policia, pavarësisht se ky detyrim social është pranuar me nënshkrimin e deklaratës personale, kur ka aderuar si anëtar i sindikatës. Madje, te kjo e fundit ishte debati dhe më i fortë, pasi policia nuk pranonte të mbante kuoti-

zacionet, pavarësisht vullnetit të lirë të punonjësve. Pyetjes nëse mund të arrihej një marrëveshje për këtë çështje, përfaqësuesit e policisë u shprehën se duhen pyetur drejtuesit e tyre, pavarësisht se ekziston një kontratë mes palëve, e cila nuk është respektuar nga ana e Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Në takim morën pjesë Presidenti i CESP, Andreas Symeou, Sekretari i Përgjithshëm i CESP, Geert Priem, Kryetari i Sindikatës së Punonjësve të Policisë, Sadetin Fishta, përfaqësues nga Sindikata e Policisë së Kosovës dhe përfaqësues të Sindikatave të tjera evropiane, të cilat janë anëtarë të CESP. Në këto kushte, ne po botojmë të plotë diskutimin mes palëve në takimin e mbajtur në Tiranë mes përfaqësuesve të CESP dhe atyre të policisë shqiptare, ku...

### DEKLARATA E CESP:

**Krerët e policisë shqiptare s'duan të mbështesin sindikalizmin**

**M**bi takimin e Byrosë Ekzekutive në Tiranë, CESP bëri dhe një deklaratë për mediet, duke shprehur zhgënjimin e thellë për drejtuesit aktualë të policisë. Në faqen e saj zyrtare, CESP publikoi deklaratën ku shprehej se takimi i radhës u mbajt në Tiranë me qëllim të ...

Faqe 3



### REKOMANDIMET

**Avokati i Popullit: Drejtuesi i policisë po ndërhyt në punët e Sindikatës**

**M**osmarrëveshjet mes Sindikatës së Punonjësve të Policisë dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit janë përcjellë herë pas here edhe nga Avokati i Popullit, i cili ka bërë rekomandimet përkatëse, por duket se ato kanë rënë në vesh të shurdhët. Avokati i Popullit, duke...

Faqe 4

# CESP, krerëve të policisë: Respekttoni kontratën, ose do ankohe mi në Strasburg

*Diskutimi i plotë mes përfaqësuesve të policisë dhe drejtuesve të sindikatës europiane të policisë*

**B**llokimi që Policia e Shtetit i ka krijuar Sindikatës së Punonjësve të Policisë prej më shumë se tre vitesh ka detyruar drejtuesit e Këshillit të Sindikatave Europiane të Policisë (CESP) që të vijnë në Shqipëri dhe të organizojnë një takim me drejtuesit e policisë shqiptare. Takimi u organizua në fillim të muajit mars. Gjatë një diskutimi të nxehtë u duk qartë se përfaqësuesit e policisë nuk donin të mbështesnin sindikalizmin dhe nuk kishin dëshirë të respektonin kontratën kolektive të firmosur që në vitin 2009, duke vendosur kushte të reja, edhe pse CESP deklaroi se për mohimin e këtyre të drejtave do të ndjekë të gjithë hapat ligjore, deri në gjykatën e të drejtave të njeriut në Strasburg. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Avokatit të Popullit, të cilët herë pas here kanë dhënë rekomandime për zgjidhjen e këtij ngërçi, por nuk janë marrë parasysh nga Drejtoria e Policisë së Shtetit. Diskutimi i nxehtë, i cili zgjati mbi një orë u përqendrua kryesisht te bllokimi që policia i ka bërë sindikatës, duke u bazuar në tre shtylla kryesore, largimi i saj nga zyrat sipas kontratës kolektive, heqja nga puna ose transferimi i drejtuesve sindikalë, pa u konsultuar më parë me sindikatën dhe bllokimi i kuotizacioneve të derdhura nga punonjësit e policisë, veprim i ndërmarrë nga policia, pavarësisht se ky detyrim social është pranuar me nënshkrimin e deklaratës personale, kur ka aderuar si anëtar i sindikatës. Madje, te kjo e fundit ishte debati dhe më i fortë, pasi policia nuk pranonte të mbante kuotizacionet, pavarësisht vullnetit të lirë të punonjësve. Pyetjes nëse mund të arrihej një marrëveshje për këtë çështje, përfaqësuesit e policisë u shprehën se duhen pyetur drejtuesit e tyre, pavarësisht se ekziston një kontratë mes palëve, e cila nuk është respektuar nga ana e Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Në takim morën pjesë Presidenti i CESP, Andreas Symeou, Sekretari i Përgjithshëm i CESP, Geert Priem, Kryetari i Sindikatës së Punonjësve të Policisë, Sadetin Fishta, përfaqësues nga Sindikata e Policisë së Kosovës dhe përfaqësues të Sindikatave të tjera evropiane, të cilat janë anëtarë të CESP. Në këto kushte, ne po botojmë të plotë diskutimin mes palëve në takimin e mbajtur në Tiranë mes përfaqësuesve të CESP dhe atyre të policisë shqiptare, ku të pranishëm ishin dhe përfaqësues të Avokatit të Popullit. Pas hapjes së takimit, i pari që foli mbi përplasjen mes sindikatës dhe policisë ishte drejtori i drejtorisë juridike të policisë, i cili dha pretendimin e tij se ku ka ngecur kjo çështje.

**Drejtori juridik i policisë:** Korrespondencat tona dhe me sindikatën e policisë parashikonin disa ndryshime, të cilat kishin të bënin me rinovimin apo risjelljen e deklaratave të reja për shkak të ligjit të ri, edhe ndryshimet që ka pësuar struktura. Kemi kërkuar që këto deklarata të shërbejnë për të ditur kush punonjësi aderon për anëtar sindikate, por kemi pasur parasysh edhe Kodin e Punës, i cili jo domosdoshmërisht e ngarkon institucionin tonë me detyrimin për mbledhjen e kuotizacioneve dhe duke plotësuar këto kushte, kemi parasysh faktin që të plotësoheshin deklaratat nominale nga e para. Së dyti, marrja e autorizimeve përkatëse për punonjësit të cilët aderonin në sindikatë, Drejtoria e Policisë së Shtetit kishte shprehur gatishmërinë për të rinovuar kontratën.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Mendoj se e kuptoj pozicionin tuaj dhe shpjegimin që dhatë sepse edhe policia duhet të ndjekë ligjin. Ajo çfarë nuk e kuptoj mirë, te ligji i vjetër lejohej kalimi i kuotizacionit të anëtarëve të sindikatës në llogarinë e sindikatës.

**Drejtori juridik i policisë:** Ishte dakordësuar në këtë formë në kontratë.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Derisa nuk ka një marrëveshje të re kolektive, normalisht duhet të ndiqet kjo linjë siç ka qenë më përpara dhe të pritet certifikimi i marrëveshjes së re dhe shtojcave që do të bëhen.

**Drejtori juridik i policisë:** Çështja është se në momentin që ka hyrë në fuqi ligji i ri i policisë së shtetit, pikërisht në nenin 144 ka parashikuar që ligji i vjetër i policisë si dhe dispozi-



tat e tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë, por që bien ndesh me ligjin e ri, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

**Kryetari i Sindikatës:** Dua t'i referohem asaj që tha vetë drejtori juridik, neni për sindikatën i ligjit të ri, çfarë ka ndryshuar përveçse ka lejuar të bëhen më shumë sindikata, përkundrazit e ka përmirësuar, por nuk e ka penguar. Ajo nuk pengon sindikatën ekzistuese me krijimin e sindikatave të tjera, përkundrazit e forcon, kështu që nuk shikoj juridikisht faktin që bie ndesh dhe nuk shikoj sesi del këtu një pengesë ligjore për të vendos ndalimin ose mosrespektim e kontratës deri në momentin e ndryshimeve përkatëse.

**Drejtori juridik i policisë:** Nga ana jonë, përkundrazit është zbatuar kontrata dhe dispozitat e saj, ku thuhet që "me ndryshimin ligjor është e nevojshme rinovim kontratë". Pastaj duke pasur parasysh edhe parime të tjera ligjore, e kemi parë të nevojshme ndryshimin edhe për problematikën e kuotizacioneve, për shkak të vështirësive në mbledhjen e tyre dhe mungesës së deklaratave autorizuese, të cilat ia kemi kërkuar disa herë përfaqësuesve të Sindikatës.

**Kryetari i Sindikatës:** Sa për problemin e deklaratave, e keqja e kësaj është se u ndryshua stafi i drejtuesve të Policisë së Shtetit dhe ky staf nuk ishte i trajnuar për të marrë informacionin e nevojshëm sesi funksionon sindikata. Fakti që këto që thonë janë vetëm të përgjithshme dhe nuk i referoheni asnjë neni konkret tregon që Drejtoria e Policisë, akoma nuk e ka të qartë se vepron mbi bazën e statutit dhe mbi bazën e kontratës kolektive që të dyja bashkëlidhen. Çdo veprim që kryhet në anëtarësi rregullohet nëpërmjet statutit dhe çdo kërkesë për ndryshimin e statutit nuk është e drejtë e Policisë së Shtetit, por është e drejtë e Sindikatës dhe vetë forumit të lartë që ka sindikata. E gjithë praktika që kemi vendosur për mbledhjen e kuotizacionit është e bazuar në këtë statut dhe ligjit të policisë së Shtetit, qoftë të ligjit të ri, ashtu edhe atij të mëparshëm. Përsërisht ka vetëm një ndryshim, atë të lejimit të krijimit të shumë sindikatave. Por fakti i lejimit të shumë sindikatave nuk do të thotë që të pengosh aktivitetin e asaj të krijuar më parë dhe këtë nuk mund ta gesh në asnjë Ligj apo Kod. Të gjitha ndryshimet në kontratë janë bazuar në rregullat ligjore mes punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe vjelja e kuotizacioneve janë përcaktuar nga Kodi i Punës, ku shprehet se mbi bazën e deklaratës së punonjësit të policisë, punëmarrësi ka të drejtë të bëjë ndalesën përkatëse, pasi ajo është e lidhur drejtpërdrejt me statutin. Nëse këto që thashë, mund t'i vërtetojë edhe Avokati i Popullit që është i pranishëm dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për këtë çështje.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Këtu jemi diskutuar mbi një subjekt, që të dyja palët kërkojnë ta mbrojnë, pikërisht punonjësin e policisë. Në parim ne kërkojmë t'i japim të gjitha të drejtat që u jep ligji, nga ana tjetër sindikata kërkon të mbrojë zbatimin e ligjit për punonjësin e policisë. Po merremi me ligjin dhe kemi harruar parimin e vullnetarizmit. Ne si strukturë e kemi të normuar me ligj se çfarë i ndalojmë një punonjësi policie nga paga. Ato që janë ndaluar me ligj, janë pranuar me raportin punëdhënës-punëmarrës. Çdo detyrim tjetër i ndaluar nga e drejta sociale e punonjësit të policisë normon ose me ligj ose mbi bazë të drejtës së vullnetarizmit. Pjesën e ndalesës së ligjit nuk kemi pse ta diskutojmë në këtë panel. Pjesën e vullnetarizmit duhet ta diskutojmë. Është Kodi i Punës që mundëson një marrëveshje mes palëve mbi bazën e vullnetarizmit, është edhe Kodi Civil që normon të drejtën e individit për të ndaluar në bazë të vullnetarizmit një detyrim. Gjithë ky diskutim është te kuota, nuk është një diskutim më shumë dashamirës sesa kuota. Një sindikatë krijohet mbi bazën e anëtarësisë dhe vullnetarizmit të anëtarësisë. Ne jemi punëdhënësit e një trupe policore dhe për të personalizuar një penalizim social kërkojmë vullnetarizmin. Pra kërkojmë pranimin vullnetar të çdo punonjësi policie që aderon si anëtar në sindikatë, të pranojë vullnetarisht ndalesën për kuotizacionit. Ne insistojmë shumë tek ndalesa nëpërmjet Policisë së Shtetit, pasi vullnetarizmi e ka përcaktuar që kuotën e anëtarësisë të paguajë çdo individ nëpërmjet llogarisë së tij dhe elektronika ka përcaktuar shumë mënyra për shlyerjen e këtij detyrimi. Kështu e gjykojmë ne se funksionon parimi i vullnetarizmit.

**Juristi i Sindikatës:** Lidhur me këtë fakt dua të them se unë kam tre vjet që merrem me Sindikatën e Punonjësve të Policisë së Shtetit, kam drejtuar dhe një mision të Bashkimit Europian në Shqipëri që ka të bëjë me lirinë sindikale dhe faktikisht jam shumë dakord mbi parimet e vullnetit. Por parimet e vullnetit ishin ndërtoar mbi bazën e një kontrate kolektive. Në momentin që ju menduat të ndryshuat këtë kontratë kolektive, që para tre viteve dhe deri më sot, nuk ka ende nuk amendament nga ana juaj.

**Drejtori juridik i policisë:** I kemi nisur zyrtarisht sindikatën një kërkesë

**Juristi i Sindikatës:** Kërkesa dhe shkresa ka, por një draft sesi mendoni ju të zgjidhet ky ngërç për mbledhjen e kuotizacionit nuk ka.

**Drejtori juridik i policisë:** Ne i kemi kërkuar Sindikatës që këtë pikë nuk e negociojmë për shkak të mungesës së deklaratave, vullnetarizmit, në të cilën duhet të bazohemi. Fakti që ne kemi pasur korrespondencën me synim amendimin, ndryshimin e kon-

tratës kolektive dhe për aq kohë sa nuk kemi disponuar deklarata nominale vullnetare, kontrata kolektive ka qenë e pezulluar deri në gjetjen e një zgjidhje dhe kemi qenë në pritje të një përgjigjeje nga sindikata, e cila ka gati një vit që nuk ka kthyer përgjigje mbi bazën e kushteve tona që i vendosëm.

**Kryetari i Sindikatës:** Që kur është krijuar sindikata si person juridik, të gjithë punonjësit e policisë janë njohur me statutin e sindikatës, që ishte pjesë e gjithë dokumentacionit juridik që Sindikata ka paraqitur dhe me vendim të gjykatës të formës së prerë është shpallur sindikata si person juridik. Ky statut, jo vetëm që është miratuar me vendim gjykatë, por është marrë mendim për krijimin e tij edhe nga Ministria e Punës dhe çështjeve sociale, sepse pa miratimin e tyre gjykata nuk jep vendim. Pas marrjes së mendimit, ky statut u përhap në të gjithë policinë e Shtetit dhe mbi bazën e tij u firmosën të gjithë deklaratat e anëtarësisë në mënyrë vullnetare dhe konkretisht neni 10 i Statutit thotë që "Për anëtarësinë në Sindikatë, punonjësi i Policisë nënshkruan deklaratën personale për anëtarësi, anëtarit i jepet librezja e anëtarësisë, e cila duhet të dorëzohet me daljen eventuale nga sindikata së bashku me kërkesën me shkrim të tij. Ne si sindikatë u bëjmë një pyetje zotërinjve të policisë: Është e drejta e tyre që të gjykojnë që deklaratat që dorëzojnë nuk qenkan vullnetare, apo ky është një problem i sindikatës? Pra apo ndërhyhet direkt në punët e sindikatës? Ky statut është me vendim gjykatë, është i miratuar.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Së pari statuti është i sindikatës, jo i Policisë së Shtetit. Nuk normon deklaratat.

**Kryetari i Sindikatës:** Kemi mbi 7 mijë deklarata.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Nuk i kemi ato deklarata.

**Kryetari i Sindikatës:** Atëherë nuk është faji jonë që ju nuk i keni, pasi ne i kemi dorëzuar. Këtu kemi një dosje me të gjitha deklaratat. Këtu kemi dhe listën me të gjitha firmat tuaja.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Nuk i dua fare ato deklarata. Po dalim në një konkluzion të çuditshëm. Insistimi për t'i mbajtur patjetër punonjësit të policisë kuotën për sindikatën të paga. Derisa është vullnetarizmi le ta paguajë kuotën tek llogaria e vet financiare në llogarinë e sindikatës. Nga periudha që nuk është mbajtur detyrimi financiar në pagesën e punonjësit të policisë për llogarinë e sindikatës, nuk kemi asnjë ankesë pse nuk është mbajtur ndalesa për sindikatën, sikurse nuk kemi asnjë deklaratë që të mbahet ndalesa në llogarinë e vet. Nëse punonjësit të policisë, sindikata ia mbron të drejtat atëherë me vullnetarizëm ia paguan kuotën e anëtarësisë sipas ligjit sipas llogarisë financiare. Nuk besoj se duhet të diskutojmë në panel detyrimin medoemos që t'i mbajmë punonjësit të policisë, të cilin nuk e kemi prezent, pagesën për llogari të sindikatës, ndërsa nuk kemi asnjë rast që thotë pse nuk është mbajtur detyrimi për kuotën e sindikatës dhe nuk marrim përsipër t'i ndalim punonjësit të policisë pa pasur një deklaratat me vullnetarizëm.

**Juristi i Sindikatës:** Jam dakord me ty nëse me lejon, por ne i kemi ato deklarata dhe i ka dhe Policia e Shtetit, të cilat janë dorëzuar në bazë të marrëveshjes.

**Kryetari i Sindikatës:** Do t'u vë në dispozicion një urdhër të drejtorit që ke sot, ku thuhet që kopjet e deklaratave





## DEKLARATA

*Si një qytetar evropian, më duket e pabesueshme dhe e papranueshme, mungesa e dialogut social, dhuna dhe shkelja e një sërë ligjesh për të drejtat ligjore të punonjësve të policisë së shtetit*

# Deklarata e CESP: Drejtuesit e policisë shqiptare nuk duan të mbështesin sindikalizmin

**M**bi takimin e Byrosë Ekzekutive në Tiranë, CESP bëri dhe një deklaratë për mediet, duke shprehur zhgënjimin e thellë për drejtuesit aktualë të policisë. Në faqen e saj zyrtare, CESP publikoi deklaratën ku shprehej se takimi i radhës u mbajt në Tiranë me qëllim të mbështesë Sindikatën e punonjësve të policisë shqiptare për tu përpjekur t'i jepen fund problemeve të tyre me Drejtorin e Përgjithshëm

te Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme.

"Pas një diskutimi tejet të nxehte u be e qarte se Drejtoria e Policisë nuk dëshironte të mbështeste sindikalizmin dhe nuk kishte dëshirën të vazhdoje me procedurën e rene dakord me Kontratën Kolektive në fuqi për mbledhjen e kuotizimit në llogari të Sindikatës, edhe pse ata e morën qarte mesazhin se CESP ishte gati të bënte një ankese kolektive në Gjykatën Euro-

piane të Strasburgut", thuhet në deklaratën e CESP, ku shtohet se Presidenti dhe Sekretari Përgjithshëm i CESP kërkuan nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme për të bere të mundur ekzistencën e dialogut konstruktiv social midis Sindikatës dhe Qeverisë. Në 4 Mars, CESP se bashku me SPPSH-ne mbajtën një konferencë për shtyp, në prani të disa televizioneve shqiptare ku informuan ata për situatën në vend.

← janë depozituar në degët e financave. Nuk është faji jonë që keni ardhur më vonë drejtor dhe nuk e njihni këtë procedurë dhe kërkon procedurë të re. E keni me urdhër që janë shpërndarë deklaratat tona në të gjitha degët e financave.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Në bazë të ligjit të ri të Policisë së Shtetit, i cili normën më shumë se një sindikatë, ju nuk keni të drejtë të qëndroni në pozitë e mëparshme sepse ligji ua kërkon një marrëveshje të re, pasi ligji është ndryshuar, jo ka ndryshuar një nen a një tjetër, por është një bazë ligjore e re që normon punën e policisë dhe veprimtarinë e saj. Ky ligj i ri normon një detyrim për një marrëveshje të re, meqë do ketë një apo më shumë sindikata. Sindikata nuk mund t'i kërkojë shërbimin financiar për punonjësit e policisë për të gjitha sindikatat apo organizatat e veta. Imagjinoni sikur të kemi 2-3 apo 5 sindikata, të gjitha do të kërkojnë këtë shërbim financiar që t'i shërbejë policia. Prandaj ne kërkojmë marrëveshje të re me kushte të reja. Ne mbrojmë policinë, nuk po them më shumë, por aq sa e mbron dhe ju si sindikatë.

**Avokati i Popullit:** Avokati i Popullit e ka trajtuar në vijimësi problematikën ndërmjet Sindikatës dhe Policisë së Shtetit, duke e konsideruar atë si partner të rëndësishëm në jetën sociale, në mbrojtje të të drejtave të anëtarëve të saj, por edhe në gjykim të interesave të të gjithë shoqërisë. Duke qenë ndërmjetës në këtë pozicion, Avokati i ka paraqitur në vijimësi për më shumë se tre vitesh, rekomandime për zgjidhjen e kësaj situatë të krijuar ndërmjet sindikatave dhe drejtuesve të organeve të policisë. Në rekomandimin tonë ka mbizotëruar fakti që në një marrëveshje të re që duhet bërë, ose një ligj i ri i miratuar nuk duhet të përkeqësojë pozicionin e palëve. Këto kanë qenë raste të ngjashme në interpretime të Gjykatës Kushtetuese, por dhe vendimeve të gjykatave ndërkombëtare, si ajo e të drejtave të njeriut në Strasburg. Në këtë frymë duhet trajtuar edhe situata e krijuar. Pra nëse ligji aktual e përkeqëson pozitën e palëve, duhet riparë ligji. Kjo ka qenë qasja jonë rreth këtij problemi.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Për mua është shumë pozitiv fakti që dha mendimin e vet edhe Avokati i Popullit, sepse askush nuk do që të japë pretendime më tepër. Kemi një pikëpamje të veprimtarisë me ligjin e vjetër dhe mbrapa ligjit të vjetër dhe unë di që çdo-kush kërkon më të mirën për çdo punonjës

policie dhe në rastin konkret, edhe sindikata, si një sindikatë e mirë. Këtu kemi dhe mesin e artë, prandaj dua të pyes sesi i shikon policia rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit si partner i jashtëm në këtë situatë, pasi unë kam frikën se të njëjtin problem do ketë edhe po të kemi sindikata të tjera të reja që mund të krijohen. A mund të gjendet një dakordësi për këtë periudhë kalimtare.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Ne zgjidhjen e kemi dhënë, ne kemi kërkuar marrëveshje të re. Ligji i ri është një arsye objektive për të bërë një marrëveshje të re, që do të ketë së pari vullnetarizmin për kuotizim. Ne të dy palët këtu themi se flasim për anëtarësinë, anëtarësinë nuk e kemi në këtë mes. Ne themi se e mbrojmë si punëdhënësi, pala tjetër thotë se e mbron si punëmarrës, anëtarësinë e kemi në mesin tonë. Kjo anëtarësi duhet të na japë autoritetin për t'i cenuar të drejtën sociale. Kjo anëtarësi ka tre vjet, thuhet se ka 3 ose 4 vjet, ju i keni shkresat nëpër sirtarë, ne faktikisht këtë kemi kërkuar: Na jepni autorizimin e anëtarësisë që janë dakord për të prekur të drejtën e tyre sociale.

**Juristi i Sindikatës:** Kjo faktikisht është thënë së fundmi, por autorizimi jepet nëpërmjet deklaratave të depozituara te ju. Fillimisht, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka filluar duke pushuar nga puna të gjithë drejtuesit sindikalë, anëtarët themelues të kësaj sindikate, duke i lënë pa mbrojtje sindikale, pa u konsultuar me Sindikatën.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Kjo është temë tjetër

**Juristi i Sindikatës:** Pastaj dolët me një urdhër, ku e keni nxjerrë sindikatën nga zyra.

**Drejtori Juridik i Policisë:** Ne filluam të zbatojmë kontratën, pasi ishin mbajtur verbërisht kuotizacionet dhe çdo veprim tjetër. Është në nenin 19 të kontratës.

**Kryetari i Sindikatës:** Ky nen bën fjalë për zyrat në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ne kemi punuar 6 muaj në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe pastaj kemi marrë zyrat e reja në komisariat, prandaj mos e keqinterpretimi atë nen për të justifikuar veprimet arbitrare.

**Juristi i Sindikatës:** Me këtë ne duam të vëmë në dukje një tjetër problem. Anëtarët e Sindikatës, kush do i mbron, kur sulmuat drejtpërdrejt sindikatën me këto veprime. Na thoni një shkresë të vetme, ku policia i ka kërkuar sindikatës miratimin për lirim të një drejtuesi rajonal të sindikatës, që ka qenë

punonjës i Policisë së Shtetit, ashtu siç është cilësuar në kontratë. Veç këtij fakti, ne kemi një vendim gjykatë të shkallës së parë që detyron policinë që të konsultohet me sindikatën për lirim të punonjësve të policisë, që janë të zgjedhur në strukturat drejtuese sindikale.

**Presidenti i CESP:** Ju si përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, a e njihni prezencën e sindikatës, një sindikatë që ka anëtarë, që ka një statut?

**Drejtori i Financës i Policisë:** Ne e njohim faktin se sot për sot ka një sindikatë në polici, të cilët u krijuan dhe realizuan marrëveshje në bazë të ligjit të vjetër. Ndryshimet janë objektive, kështu që kërkojmë nga kjo sindikatë dhe sindikatat e tjera që do të krijohen, të negociojmë për marrëveshje të re. Kërkojmë nga sindikata aktuale e policisë, e cila ka ndërtaur ...

**Presidenti i CESP:** Pyetja ishte e thjeshtë. Deri tani nuk kemi asnjë sindikatë tjetër policie, kjo do të thotë se nuk duhet të ketë fare sindikatë në polici.

**Drejtori i Financës i Policisë:** Ekziston një sindikatë që kërkojmë të negociojmë kushte të reja objektive, pra një marrëveshje të re me policinë.

**Presidenti i CESP:** Shqipëria është një vend që aderon për në BE, kështu që i duhet të jetë aktive për dialogun social. Që të mbyllet një sindikatë dhe të krijohet një tjetër, kjo nuk mund të bëhet. Problemi është se sindikata ka statutin e saj dhe në statut është shkruar qartë që çdo anëtar bie dakord të paguajë kuotizacionin me pranimin e tij në sindikatë, pra i kanë plotësuar deklaratat e anëtarësisë. A e njihni ju statutin aktual të sindikatës?

**Drejtori i Financës i Policisë:** Derisa u shtrua një pyetje, unë do i përgjigjem. Çdo anëtar paguan kuota, le t'i paguajë, kush i ndalon të paguajnë kuotën.

**Presidenti i CESP:** Si ka qenë e zgjidhur më parë?

**Drejtori i Financës i Policisë:** Duke qenë se është një sindikatë e vetme ka qenë e zgjidhur që marrëveshja mori përsipër që nëpërmjet financës të ndalohej detyrimi.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Kur çdo anëtar i sindikatës ka një deklaratë personale të firmosur, si duhet vepruar?

**Drejtori i Financës i Policisë:** Është e thjeshtë, anëtar i sindikatës mund ta paguajë në çdo vend, teknologjia ka krijuar shumë kushte për t'u paguar kuota e anëtarësisë. Nuk

është vetëm kjo arsyeja pse jemi mbledhur. Arsyeja është që ne të krijojmë një marrëveshje të re mes palëve, pasi përfaqësojmë një subjekt të caktuar që nuk është pak. Duket sikur ne po insistojmë që t'i marrim punonjësit të policisë kuotën nëpërmjet financës, ndërkohë që ne nuk e kemi deklaratën e vullnetarizmit të këtij punonjësi policie, i cili i jep tagrin një shërbimi financiar për t'i ndalur kuotizacionin.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Pra ju doni deklaratë personale nga çdo anëtar i sindikatës që të vijë pranë jush për të kryer këtë shërbim?

**Drejtori i Financës i Policisë:** Kodi Civil ka normuar tagrin, të drejtën e ndalesës sociale vetëm nëpërmjet vullnetarizmit të individit, të cilit i cenohet e drejta sociale. Përveç detyrimeve të normuara ligjorisht, të pranuar ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, shërbimi i financës nuk ka asnjë të drejtë të cenojë elementin social me detyrim, pa autorizim.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Edhe në rastin kur keni deklaratat?

**Drejtori Juridik i Policisë:** Ne kemi kërkuar edhe në bisedime edhe në shkresat zyrtare që kemi pasur me sindikatën, që referuar në autorizim me shkrim nga punëmarrësi, mund t'i zbrësë nga paga kuotizacionet përkatëse. Për shkak të ndryshimeve strukturore, ne nuk kemi pasur listë anëtarësie të nënshkruar nga çdo anëtar sindikate, kjo para se të hynte në fuqi ligji i ri i policisë, ndërsa pas hyrjes në fuqi, Drejtoria e Policisë, ndryshe nga sa po vepron sindikata, i ka kërkuar kushte të reja, duke u referuar në të gjithë bazën ligjore të re, që ka hyrë në fuqi dhe nuk e kemi parë si element thelbësor mbledhjen e kuotizacionit nga ana e Drejtorisë së Policisë.

**Sekretari i Përgjithshëm i CESP:** Si një qytetar evropian, më duket e pabesueshme dhe e papranueshme, mungesa e dialogut social, dhuna dhe shkelja e një sërë ligjesh për të drejtat ligjore të punonjësve të policisë së shtetit, sindikalistë. Nuk është hera e parë që ne vijmë këtu për zgjidhjen e këtij problemi, prandaj kërkojmë gjetjen e një zgjidhje sa më pozitive, që të mundësojmë ekzistencën e sindikatës së punonjësve të policisë së shtetit shqiptar. Nëse situata do të vazhdojë e tillë siç është, ne si CESP na duhet të ndërmarrim hapat tonë dhe të tërë shpresojmë që nuk do të jetë e nevojshme të ndërmarrim këto hapa ligjorë deri në Strasburg.

**REKOMANDIMET****Avokati i Popullit për Policinë e Shtetit**

1. Zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës nr 1966 Prot., datë 03.04.2009, të lidhur ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Zgjidhjen e menjëhershme të problemit të kuotizacionit që punonjësit e policisë paguajnë si anëtar të kësaj Sindikate, duke mbajtur vlerën 0.5% të pagës bazë mujore të çdo anëtari dhe derdhjen e saj në llogarinë bankare të Sindikatës.
3. Shpejtimin e negociatave ndërmjet përfaqësuesve të Sindikatës dhe të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, duke gjetur një zgjidhje konsensuale, me qëllim miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore të Kontratës në përputhje me ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".



# Avokati i Popullit: Kreu i policisë ndërhy në punët e Sindikatës

## Rekomandimet për moszbatimin e kontratës kolektive

Mosmarrëveshjet mes Sindikatës së Punonjësve të Policisë dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit janë përcjellë herë pas here edhe nga Avokati i Popullit, i cili ka bërë rekomandimet përkatëse, por duket se ato kanë rënë në vesh të shurdhët. Avokati i Popullit, duke parë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Sindikata, por dhe nga Drejtoria e Policisë, ka kërkuar zbatimin e kontratës, e cila sipas këtij institucioni mbetet në fuqi, derisa të miratohen ndryshimet e reja. Madje, këto rekomandime janë përsëritur disa herë, por duket se Policia e Shtetit nuk i ka marrë parasysh, duke vendosur arbitrarisht, në mënyrë të njëanshme mos-

**“Ndërkohë konstatojmë se, në rastin konkret është bërë ndryshimi i kushteve të Kontratës Kolektive të Punës pa pëlqimin e Sindikatës, në mënyrë të njëanshme dhe pa pasur shkaqe të parashikuara me ligj**



“Ndërkohë konstatojmë se, në rastin konkret është bërë ndryshimi i kushteve të Kontratës Kolektive të Punës pa pëlqimin e Sindikatës, në mënyrë të njëanshme dhe pa pasur shkaqe të parashikuara me ligj. Ky veprim përbën ndërhyrje të kundërligjshme të punëdhënësit në funksionimin e veprimtarisë së Sindikatës, duke i sjellë kësaj të fundit pasoja të rënda në ushtrimin e misionit ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të punonjësve të Policisë së Shtetit të cilët janë anëtar të saj”, thuhet në rekomandim.

Më tej, AP vë në dukje se parvësisht përpjekjeve që po bëhen për zgjidhjen e këtij problemi duke

**Ndryshimi i kontratës kolektive përbën ndërhyrje të kundërligjshme të punëdhënësit në funksionimin e veprimtarisë së Sindikatës, duke i sjellë kësaj të fundit pasoja të rënda në ushtrimin e misionit ligjor**

respektimin e kontratës kolektive.

Në rekomandimet e veta, Avokati i Popullit ka vënë në dukje se nga shqyrtimi i ankesës së sindikatës, të përgjigjeve të dërguara nga ana Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të Kontratës Kolektive të Punës lidhur ndërmjet Sindikatës dhe DPP-së, datë 03.04.2009 dhe legjislacionit që rregullon veprimtarinë sindikale, u konstata se njëri nga aktet normative mbi bazën e të cilit është lidhur Kontrata Kolektive e Punës, është edhe ligji “Për Policinë e Shtetit”. Sipas nenit 2 të kësaj Kontrate rezultoi se ajo është lidhur me një afat të papërcaktuar. Në nenin 8 të saj është parashikuar detyrimi i punëdhënësit (DPP-se), që të mbajë, në bazë të kërkesës me shkrim të Sindikatës nënshkruese dhe deklarimit (sipas listës së anëtarëve të nënshkruar nga çdo anëtar i sindikatës kuotizacionin përkatës sipas statutit të Sindikatës në vlerën 0.5 % të pagës bazë mujore të çdo anëtari, shumë e cila kalon në llogarinë bankare

të Sindikatës brenda 10 ditëve nga data e pagimit të saj. Në nenin 16 është parashikuar detyrimi i palëve nënshkruese të Kontratës që të respektojnë nenet përkatëse të saj. Në nenin 17 është parashikuar detyrimi i palëve për të pasqyruar aktet ligjore e nënligjore që lidhen me objektin e saj. Ndërkohë është parashikuar edhe mundësia e pezullimit ose e pushimit para kohe të kësaj Kontrate, por ajo është e kushtëzuar, vetëm me marrëveshje midis palëve.

Po ashtu, Avokati i Popullit e ka cilësuar të padrejtë, të kundërligjshme dhe ndërhyrje të punëdhënësit në funksionimin e veprimtarisë së Sindikatës, qëndrimin e Drejtorit të Financave, që ka vepruar me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, duke dërguar telegramin urgjent, datë 21.07.2014, ku u kërkon të gjithë Njësive shpenzuese në varësi të Policisë së Shtetit moskryerien e ndalesave për kuotizacionin që punonjësit e Policisë së Shtetit paguanin në masën 0.5 % të pagës mujo-

re deri në rishikimin dhe miratimin e një marrëveshjeje të re. Sipas AP-së, justifikimi i bërë për këtë ndërhyrje, duke iu referuar ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, nuk është i drejtë dhe i bazuar. “Është me rëndësi që të theksojmë se ky ligj, ndonëse është miratuar në datën 31.07.2014, në bazë të nenit 145 të tij, ai hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Nga verifikimi i bërë rezultoi se ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, të vitit 2014, në datën 01.09.2014 dhe për rrjedhojë ka hyrë në fuqi në datën 01.03.2015. Pra, edhe sikur ligji i ri të jepte të drejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të ndërhyrë në mënyrë të njëanshme në Kontratën lidhur me mbajtjen e kuotizacionit, ndërhyrja nuk duhet bërë pa hyrë në fuqi ligji. Në fakt ka edhe një argument tjetër që provon se kjo ndërhyrje nuk lidhet me ndryshimet “thelbësore” të ligjit të ri, sepse ndërhyrja është bërë jo vetëm para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por edhe

para miratimit të tij, që në datën 21.07.2014, ndërkohë që ligji është miratuar në datën 31.07.2014”, argumenton Avokati i Popullit.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, AP arriti në konkluzionin se, Kontrata Kolektive e Punës nr. 1966 Prot., datë 03.04.2009 lidhur nëpërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është në fuqi. Qëndrimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke porositur Drejtorin e Financave, i cili ka urdhëruar Njësitet Shpenzuese në varësi të Policisë së Shtetit, që të mos kryejnë ndalesat për kuotizacionin që punonjësit e Policisë së Shtetit paguanin në masën 0.5% të pagës mujore deri në rishikimin dhe miratimin e një marrëveshjeje të re, është e padrejtë, i pa bazuar në Kontratë dhe në ligjin që ka qenë në fuqi në atë kohë nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Por kjo e drejtë nuk parashikohet as në ligjin aktual nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

bërë propozimet përkatëse për ndryshimin e saj, gjykohej se është e drejtë që të mos vazhdojë bllokimi i kuotizacionit sindikal.

Ndodhur në këto rrethana dhe me qëllim rivendosjen e të drejtës së shkelur të Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit, Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës, të lidhur ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Zgjidhjen e menjëhershme të problemit të kuotizacionit që punonjësit e policisë paguajnë si anëtar të kësaj Sindikate, duke mbajtur vlerën 0.5% të pagës mujore të çdo anëtari dhe derdhjen e saj në llogarinë bankare të Sindikatës dhe shpejtimin e negociatave ndërmjet përfaqësuesve të Sindikatës dhe të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, duke gjetur një zgjidhje konsensuale, me qëllim miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore të Kontratës në përputhje me ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

# Deklarata

## Kryesia ekzekutive: 4 shkeljet e Drejtorisë së Policisë ndaj punonjësve



Pas mbledhjes së CESP me krerët e policisë në Tiranë, Sindikata e Punonjësve të Policisë mbledhi asamblenë e saj të përgjithshme për të vënë në dijeni të gjithë anëtarët e saj për bllokimin që policia po i bën aktivitetit sindikal. Në këtë mbledhje u theksua se Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit vazhdon përpjekjet e saj të dialogojë me drejtuesit e policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme, rrugë institucionale për përmbushjen e detyrimeve të veta në bazë të Statutit dhe Kontratës Kolektive të Punës në fuqi. Madje, pas mbledhjes, kreu i sindikatës mbajti dhe një konferencë për shtyp, duke shpjeguar se fakti që shkeljet e të drejtave të policisë, të përcaktuara shprehimisht në kontratën kolektive dhe individuale të punës kanë qenë të vazhdueshme nga ana stafit drejtues të Policisë së Shtetit dhe rekomandimet e Sindikatës në asnjë rast nuk janë marre parasysh, kanë detyruar Sindikatën që përveç rrugëve gjyqësore për të kërkuar te drejtat

e anëtareve, shkeljet i ka bere prezent edhe në nivelin e strukturave sindikaliste europiane, CESP-it, anëtar i se cilës jemi që në vitin 2010. Madje, kryesia e sindikatës së policisë vuri në dukje edhe disa nga rastet me flagrante të shkeljeve të të drejtave, siç është goditja e sindikatës nëpërmjet

**Kryesia e sindikatës së policisë vuri në dukje edhe disa nga rastet me flagrante të shkeljeve të të drejtave, siç është goditja e sindikatës nëpërmjet urdhrave të paligjshëm**

urdhrave të paligjshëm, me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të nxjerrje sindikatën nga zyrat si dhe bllokimi i derdhjeve të kuotizacioneve me qëllim denigrimi dhe ulje të reputacionit duke e dëmtuar në tere strukturat vendore e qendrore të saj me anën edhe

te transferimeve dhe largimeve nga puna te drejtuesve sindikale në shkallë vendi. Po ashtu, një tjetër shkelje e rëndë konsiderohen largimet kolektive nga puna nga radhët e punonjësve të policisë, pa u konsultuar e marre me pare mendimin sindikal me motivacione të ndryshme,

**Një tjetër shkelje e rëndë konsiderohen largimet kolektive nga puna nga radhët e punonjësve të policisë, pa u konsultuar e marre me pare mendimin sindikal**

por jo ligjore. Këtë me se miri e vërtetojnë vendimet gjyqësore ku numri i punonjësve që kanë përfituar, nga 9-12 paga për urdhra të paligjshëm e ndërprerje të paligjshme të kontratës arrin në mbi 500. Sot asnjë nga drejtuesit e Policisë së Shtetit nuk mban përgjegjësi. Gjithashtu në kon-

ferencë për shtyp nuk u la pa përmendur ulja nga paga me 5500-9000 lek të reja te mbi 2000 punonjësve të policisë për shkak të suprimimit të gradës Kryeinspektor dhe mosnxjerrja në kohe e akteve nënligjore nga qeveria, duke bllokuar përfitimet ligjore të punonjësve për; pension suplementar e shërbimi; pagës deri në 25 % të pagës për vjetërsi shërbimi; ushqim falas nga shteti; sigurim jete për të gjithë punonjësit e policisë dhe trajtim me strehim falas për familjaret e policeve të rene në detyrë. "Në këto kushte, punonjësi i policisë "mbrohet" vetëm nga drejtuesit e policisë, të cilët kanë përgjegjësi për të gjithë veprimet e lartpërmendura. Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, duke qenë pjesë e Sindikatës Europiane të Policisë, ka kërkuar nga të gjitha sindikatat simotra dhe përfaqësuesit e tjerë në Këshillin Europian mbështetje për të ndryshuar situatën në favor të punonjësve të policisë", deklaroi Kryesia Ekzekutive e Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit.

## "Policia të firmosë shtesën e kontratës"

*Pas takimit me CESP, Sindikata i dërgon kërkesë kreut të policisë, Haki Çako*

E dhe pas takimit mes drejtuesve të Sindikatës Europiane të Policisë dhe përfaqësuesve të Policisë së Shtetit, Sindikata nuk ka reshtur me kërkesat e saj për firmosjen e shtesave të kontratës kolektive. Menjëherë pas takimit, Sindikata i është drejtuar me një tjetër kërkesë kreut të policisë, Haki Çako, duke e informuar mbi takimin e zhvilluar mes palëve dhe duke kërkuar që të firmoset shtesa e kontratës kolektive, me qëllim për t'i dhënë zgjidhje ngërçit të krijuar.

Sindikata e vuri në dijeni Drejtorin e Policisë për diskutimin mes palëve, ku drejtuesit e Organizatës Sindikale Europiane Policore, CESP, janë informuar për problemet mbi marrëdhëniet e krijuara ndërmjet Sindikatës së Policisë së Shtetit nga Drejtuesit të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi ndërhyrjet për bllokimin në mënyrë arbitrare që ka të bëjë me zbatimin e nenit 8 të Kontratës Kolektive, ku flitet për procedurat e kuotizacioneve, si dhe faktit kur pjesa dërmuese e punonjësve të policisë, rreth 7000 punonjës, kanë nënshkruar deklaratat e anëtarësisë, nga të cilat një kopje e disponohet nga Sindikata dhe një kopje nga sektorët e financës në Policinë Vendore, duke e pranuar me vullnetin e tyre të lirë për çdo detyrim që rrjedh nga statuti, që është detyruar për çdo anëtar që ka firmosur deklaratën personale të anëtarësisë. Çështja u trajtua me kujdes nga CESP dhe nga përfaqësuesit e institucionit të



Avokatit të Popullit dhe u rekomandua zgjidhja me mirëkuptim e në mënyrë sa më të shpejtë, të problemit të zhblokimit të kuotizacionit që punonjësit e policisë e japin si anëtarë të sindikatës.

Më tej, në kërkesën e saj, Sindikata u shpreh se do donim të gjenim mirëkuptimin tuaj në frymën e kësaj letre të motivuar dhe të rekomanduar nga CESP-i, për të realizuar bashkëpunimin për nënshkrimin e Shtojcë - Kontratës, për

### KËRKESA

**Sindikata e vuri në dijeni Drejtorin e Policisë për diskutimin mes palëve, ku drejtuesit e CESP janë informuar për problemet mbi marrëdhëniet e krijuara**

t'i hapur rrugë zhvillimeve të reja veprimtarive sindikale të punonjësve të policisë dhe të ristrukturimeve pozitive të Policisë së Shtetit. "Kjo është në interesin tonë të përbashkët për tu treguar partnerëve tanë të Sindikatës Europiane C.E.S.P, që kontributin që ata dhanë e do të japin në mbarëvajtjet dhe forcimin e veprimtarive të Sindikatës, sipas rekomandimeve të BE - së, e vlerësojmë dhe se këto probleme kalimtare

i zgjidhim vetë me vullnetin tonë të përbashkët. Në përfundim përfaqësuesit e CESP-it, për ecurinë dhe për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, dhanë një mesazh të qartë, dhe se janë të gatshëm në rast të kundërt edhe për ankesë kolektive në Gjykatën Europiane të Strasburgut. Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i saj, kërkuar nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Policisë për të bërë të mundur fillimin e dialogut konstruktiv social midis Sindikatës dhe Qeverisë", thuhet në kërkesën për Drejtorin e Policisë. Gjithashtu, Çako u vu në dijeni se CESP u njoh edhe me 'Propozimet e tij' dhe i vlerësuan ato që ishin pasqyruar, për shtesat dhe ndryshimet që duhen bërë në Kontratën Kolektive, të dokumentuara në draftin e një 'Shtojcë Kontrate'. CESP-i, kërkon që ky variant të nënshkruhet nga palët mundësisht sa më shpejt pasi çel rrugën e dialogut dhe mirëkuptimit midis palëve në marrëveshje, duke mosçenuar praktikën e mëparshme të mbledhjes së kuotizacionit. "Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, në pritje për të caktuar ju, një datë takimi, sa më të afërt me ju, për të konkluduar përfundimisht", përfundon kërkesa e Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit. Shtojca e kontratës nuk firmoset që në vitin 2016, pasi Drejtoria e Përgjithshme po e zvarrit për shkak të bllokimit të nenit 8 të kësaj kontrate, i cili flet për kuotizacionet e Sindikatës, megjithëse gjykata është shprehur pozitivisht për këtë kërkesë.

**SHKELJA****Padia për gradën kryeinspektor dhe uljen në pagë të punonjësve**

Një nga paditë e sindikatës ndaj policisë është ajo për heqjen e gradës kryeinspektor. Konkretisht, sindikata ka kërkuar pavlefshmërinë e uljes së pagës së Punonjësve të Policisë së Shtetit, me gradën Kryeinspektor, marre sipas ligjit nr. 9746 date 04.06.2007 "Per Policine e Shtetit" dhe VKM-se nr. 803 date 21.11.2007 " Per percaktimin e funksioneve korresponduese, per gradat ne Policine e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", i ndryshuar dhe VKM-ne nr. 1135, date 05.08.2008, " Per pagat e punonjesve te Policise se Shtetit" i ndryshuar. Kjo ulje është bërë me urdhrin nr. 195 date 19.03.2015 te Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit, "Per dhenie grade inspektor nga data 01.03.2016, me afat ruajtje page nje vit". Në objektin e padisë është kërkuar detyrimi i Drejtorise se Policise se Shtetit te paguajë per punonjesit e Policise se Shtetit pagen 54500 për çdo punonjes policie me graden Kryeinspektor, marre sipas ligjit nr.9746, date 04.06.2007," Per Policine e Shtetit dhe detyrimi i Policisë së Shtetit te paguajë per punonjesit diferencen e pages se ndaluar nga data 01.03.2016 e ne vazhdim.

# Sindikata, 17 padi kolektive në gjykatë për policinë dhe qeverinë

Rreth 17 çështje kolektive dhe mbi 300 të tjera individuale janë ngritur nga Sindikata e Punonjësve të Policisë në gjykatë për shkak të mosmarrëveshjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Sa i përket çështjeve kolektive, Sindikata është detyruar t'i drejtohet gjykatës për të gjitha rastet e moszbatimit të kontratës kolektive nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke filluar që nga ato të marrëdhëniesve



ndërmjet dy institucioneve e deri tek nxjerrja e akteve të paligjshme apo mosnxjerrja e atyre që janë de-

tyrim ligjor sipas ligjit të ri të policisë. Çështjet më të rëndësishme kolektive të goditura në gjykatë nga

*Mbi 300 padi civile për largime të padrejta nga puna janë fituar me asistencën juridike të ofruar nga sindikata*

ana e sindikatës kanë të bëjnë me moszbatimin e kontratës kolektive, bllokimin e kuotizacioneve, mo-

himi i një vakti ushqim për punonjësit e policisë, sigurimi i jetës për punonjësit



*Më të prekurit forcat e posaçme, reparti Shqiponja dhe RESI. Ndryshon dhe formula e vjetërsisë*

## Pagat e policisë, Fishta: Vendimi i ul deri në 15%

Rreth 2500 punonjësve të policisë së shtetit u janë ulur pagat nga 7%-15% me hyrjen në fuqi të ligjit të ri. Kategoritë më të prekura janë ato që mbajnë gradën inspektor.

Sipas kreut të sindikatës për punonjësit e policisë së shtetit, Sadedin Fishta, janë forcat e shërbimeve speciale, ato të posaçme dhe shqiponjat të cilave u është prekur shtesa në pagë. Shtesa në pagat e tyre nga 20 mijë lekë për natyrë të veçantë, sipas Fishtës, është bërë 15 mijë lekë. "Përpara këtij vendimi ekzistonte edhe një vendim tjetër qeverie ku janë përcaktuar pagesat për natyrë të

**"Pagesa për vjetërsi në punë është përcaktuar edhe në ligjin për policinë e shtetit, i takon çdo punonjësi policie, që kur ka filluar karrierën e tij policore. Ç'ndodh me zbatimin e vendimit?"**



veçantë pune. Nëse do ta krahasojmë me këtë vendim, ka luhajatje, disa punonjës policie preken nga vendimi që ka dalë kohët e fundit. Preken do të thotë që ulen në pagë, drejtpërdrejt. Ulet kjo pagesë për punonjësit e RES-it, për repartin Shqiponja, për forcat e posaçme dhe ulja varion nga 9500 lekë deri në 4500 lekë", tha Fishta.

Më tej Fishta theksoi se një tjetër problem mbetet edhe paga e

llogaritur sipas vjetërsisë në punë ku me këtë ligj vitet para 1992 nuk merren parasysh.

"Pagesa për vjetërsi në punë, është përcaktuar edhe në ligjin për policinë e shtetit, i takon çdo punonjësi policie, që kur ka filluar karrierën e tij policore. Ç'ndodh me zbatimin e vendimit? Punonjësit e policisë paguhen nga viti 1992, kur ka nisur aplikimi i gradave dhe vitet e tjera nuk u merren parasysh për vjetërsi. Kjo do të thotë se poli-

cia e shtetit ka filluar në vitin '92, s'ka ekzistuar më përpara... Janë një numër i madh punonjësish që karrierën e kanë filluar përpara '90-shit", u shpreh ai. Gjithashtu, ai shpjegon se ka ndryshuar formula e përlllogaritjes edhe në një tjetër aspekt. Më parë, punonjësit e policisë merrnin vjetërsinë, duke e përllogaritur përqindjen me pagën për gradë aktuale që kishin, por nga viti 2008 e deri më sot. Ajo ishte llogaritur 1 për qind për çdo vit pune.

Pra, punonjësit merrnin 9 për qind të pagës bazë për gradë. Ndërsa me formulën e re, punonjësit e policisë marrin 1 për qind për çdo vit pune që nga viti 1992, por jo mbi pagën bazë për gradën që kanë. Tashmë, përllogaritet 1 për qind e gradës më të vogël në polici, pra gradës inspektor. Kreu i sindikatës së punonjësve të policisë së shtetit siguroi se do ta ndjekë çështjen në çdo shkallë të gjyqësorisë, deri në Gjykatën e Strasburgut.

**Kërkesë Presidentit**

### TRANSFERIMI I HELIKOPTERËVE CENON SIGURINË KOMBËTARE

Sindikata e Punonjësve të policisë Ska kërkuar edhe ndërhyrjen e Presidentit të Republikës për heqjen e helikopterëve nga reparti RENEA dhe kalimin e kompetencave pranë Ministrisë së Mbrojtjes, duke e konsideruar këtë lëvizje si cenim të sigurisë kombëtare. Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin e keshillit të ministrave nr.464 date 02.12.2015 me ane te te cilit ka vendosur qe helikopteret dhe pajisjet e tyre si dhe struktura e posacme e efektivitetit e komisarariatit RENEA jane transferuar nga Ministria e Brendshme te e Mbrojtjes. Pervec fakti te transferimit te punonjesve pa pelqimine tyre qe eshte ne ndjekje nga Sindikata rezulton qe ky vendim i zbatuar me urdherin e perbashket te Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Mbrojtjes nr. 2057 date 22.12.2015 e nr.19 date 01.2016 cenon sigurine kombetare. Së pari u heq forcave speciale komisarariatit Renea mundesine perzgjidhjen e situatave qe kerkojne nderhyrje nga ajri me helikopter, per zgjidhjen e situatave te pengmarjes apo veprimeve me qellime terroriste. Së dyti policise se shtetit i hiqet mundesia te monitoroje teritorin e RSH me helikopteret e saj dhe cenohehet gatishmeria per tu pergjigjur ne kohe ne situata emergjente.



← e policisë, pavlefshmërinë e urdhrat të Drejtorit të Policisë dhe Ministrisë të Brendshëm për miratimin e strukturave organike, ulja në gradë e mbi 2300 kryeinspektorëve dhe shumë të tjera. Disa prej këtyre çështjeve janë fituar në shkallën e parë, ndërkohë që vijojnë në shkallët e tjera të gjyqësorit. Për të gjitha këto çështje, me mbarimin e tyre, nëpërmjet ndihmës së ofruar edhe nga Sindikata Europiane e Punonjësve të Policisë, CESP, Sindikata do i drejtohet për të fituar të drejtat e mohuara edhe Gjykatës së Strasburgut. Në gjykatën ndërkom-

bëtare do të kërkohet jo vetëm dëmi material, që i është shkaktuar sindikatës në tre vitet e fundit, por edhe dëmi jomaterial, i shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme që i janë ushtruar sindikatës në aktivitetin e saj. Këto të drejta të cenuara vërtetohen më së miri edhe nga rekomandimet e herëpashershme të Avokatit të Popullit, që i janë dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, por që nuk janë përfillur nga autoritetet e këtij organizmi.

Por veç çështjeve kolektive, Sindikata e Punonjësve të Policisë ka ndjekur nga afër dhe asistuar me ndihmë juridike mbi 300 çështje

individuale të punonjësve të policisë, të cilët janë liruar nga detyra në mënyrë të paligjshme Pjesa dërmuese e këtyre çështjeve janë fituar në të gjitha shkallët e gjyqësorit, ndërkohë që vijon puna për të rikthyer të drejtën e cenuar edhe për pjesën e mbetur të punonjësve të larguar nga puna. Gjykata në shumë raste ka rrëzuar urdhrat e lirim, si të paligjshëm dhe ka cilësuar të njëanshme ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në vendimet e saj, gjykata ka vlerësuar me shpërbllim punonjësit e policisë nga 7 deri në 18 paga, por

kthimi në punë është dhënë në raste të rralla për shkak të një vendimi unifikues. Ky vendim i ka cilësuar kontratat e punës së punonjësve të policisë me Drejtorin e Policisë si kontrata mirëbesimi dhe pavarësisht se me vendim gjykate, punonjësit i lind e drejta për t'u rikthyer në detyrën që ka pasur para lirim me urdhër të paligjshëm, punësimi i tij mbetet në vullnetin e punëdhënësit, pra Drejtorit të Policisë së Shtetit. Gjithsesi, pavarësisht ndërprerjes së dialogut social mes kreut të policisë dhe sindikatës, kjo e fundit vazhdon të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj në të gjithë strukturat e policisë.

## LIRIMI I AMBIENTEVE

**Sindikata ka paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë edhe për anulimin e urdhrat nr. 942, datë 26 qershor 2014, i nxjerrë për lirim e ambienteve që përdoren nga sindikata e punonjësve të policisë pranë komisarariatit nr. 1 në Tiranë**

## PARTNERITETI SOCIAL

**Kreu i Sindikatës, z. Fishta, thotë se për të abuzuar lirshëm me të drejtat ligjore të 11 mijë punonjësve të policisë, drejtuesit shtetërorë të këtij shërbimi, nuk përfillin partneritetin social duke mos njohur e duke mos zbatuar kontratën**

# Administrativja: Kontrata e punës, në fuqi

*Gjykata vendos kthimin e kuotizacioneve. Fishta: Drejtuesit e policisë nuk përfillin partneritetin social duke mos e njohur e duke mos zbatuar kontratën kolektive*

Gjykata e Shkallës së Parë Administrative në Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të kontratës kolektive të punës ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë dhe Drejtorit të Policisë dhe detyrimin e palës tjetër të zhblokujë kuotizacionet e mbajtura që prej vitit 2014 e deri më sot. Vendimi është marrë në muajin prill pas një odiseje të gjatë, ku sindikata kishte kërkuar detyrimin e Drejtorit të Policisë të zbatonte kontratën kolektive të punës nr. 1966, datë 03.04.2009, lidhur mes Sindikatës së Policisë së Shtetit dhe palës së paditur.

Ky bllokim ishte cilësuar si presion për të mos kërkuar të drejtat sociale të policëve. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, rezultoi, se ajo është lidhur me një afat të pa përcaktuar (pa afat) dhe në nenin 8 të saj është parashikuar detyrimi i punëdhënësit (DPP-së), që të mbajë në fuqi këtë kontratë, shoqëruar me listën e nënshkruar prej anëtarëve, gjë e cila është paraqitur prej sindikatës dhe për të mbështetur në këtë detyrim kontraktual, i duhen kaluar detyrimet e kuotizacionit të anëtarëve, në llogarinë bankare të sindikatës.

Kreu i Sindikatës së Punonjësve të Policisë Shqiptare, z. Sadedin Fishta thotë se për të abuzuar lirshëm me të drejtat ligjore të 11 mijë punonjësve të policisë, drejtuesit shtetërorë të këtij shërbimi, nuk përfillin partneritetin social duke mos njohur e duke mos zbatuar kontratën e cila i detyron ata për shumë të drejta sociale të punonjësve të këtij sektori publik! Çfarë ndodh konkretisht? Sot, po flasim për shpërfilljen e Kontratës Kolektive



të Punës. ka një ligj të shkëlqur prej policisë, për zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës Nr. 1966 Prot., datë 03.04.2009, të lidhur ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke zgjidhur problemin e kuotizacionit që punonjësit e policisë e paguanin si anëtarë të kësaj Sindikate. Në këtë shqetësim është përfshirë edhe Avokati i Popullit, me Shkresën Nr. K21S39-8 Prot., datë 26.11.2015, drejtuar Policisë së Shtetit, me të cilën në bazë të ligjit, i kërkoi të respektoj dhe zbatoj këtë kontratë. Drejtoria e Policisë së Shtetit nuk ka zbatuar nenin 8 të Kontratës Kolektive të Punës, të lidhur prej saj me sindikatën e policisë, duke e nisur këtë shpërfillje e moszbatim ligji, me bllokimin e derdhjes së kuotizacionit financiar mujor përkatës të punonjësve, në llogarinë e sindikatës, sipas Statutit të Sindikatës, caktuar në vlerën 0.5% të pagës mujore të çdo anëtar. Sindikata pretendon, se mos-derdhja e kuotizacionit nga Drejtoria e Policisë së Shtetit është bërë në bazë të një telegrami të Drej-

torit të Financës se këtij organi, me Nr. 180711, Prot., datë 21.07.2014, dërguar sektorëve të financës të të gjithë organeve të Policisë së Shtetit. Për shkak të këtij qëndrimi arbitrar e të njëanshëm, të mbajtur nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Sindikatës i është shkaktuar një dëm i madh, i cili ka sjellë si pasojë, vështirësi në funksionimin dhe veprimtarinë ligjore të saj. Gjithashtu, Sindikata pretendon se, ky veprim i kryer nga Drejtoria e Policisë së Shtetit është në kundërshtim të plotë e të hapur me Nenet 8, 16 dhe 17 të Kontratës Kolektive të Punës, lidhur ndërmjet saj dhe Policisë të Shtetit. Po kështu, ka shkëlqur Nenet 82 dhe 85 të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe Nenin 83/4 të ligjit nr. 10812014 "Për Policinë e Shtetit", si dhe ka shkëlqur Nenet 162 dhe 182111b te Kodit të Punës. Lidhur me këto Avokati popullit ka reaguar, duke theksuar: "Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën e datës 05.10.2015, ndërmjet të tjerave, na informuat se ky problem ekziston dhe për zgjidhjen e tij, Drejtoria e Policisë se Shtetit, ka

zhvilluar takime me përfaqësuesit e Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit. Ndërkohë është ngritur grupi i punës për rinegocimin e Kontratës me Sindikatën e Punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këto takime, sipas jush, Sindikatës i është kërkuar të paraqesë draftin për rinegocimin e kontratës së punës. Po sipas jush, kjo është bërë për arsye se kontrata aktuale nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit "Për Policinë e Shtetit". Gjithashtu, na informuat se kjo Drejtori është në pritje të mendimeve nga ana e Sindikatës, për zgjidhjen e këtij problemi. Ndërsa me shkresën e datës 27.10.2015, ndërmjet të tjerave, na informuat se në zbatim të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", neni 82, pikat 3, 4 e 85/3 është lidhur Kontrata Kolektive e Punës midis Sindikatës dhe DPP-së me Nr. 1966, Prot., datë 03.04.2009, duke sanksionuar edhe mundësinë e rishikimit kur ka shkaqe objektive për një gjë të tillë.

Në kushtet e ndryshimeve thelbësore në Policinë e Shtetit, filluar me miratimin e ligjit organik, me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, marrëdhënia me Sindikatën duhet rishikuar në kuadër të miratimit të ligjit të ri "Për Policinë e Shtetit" Sipas përcaktimeve të ligjit në nenin 83 është sanksionuar marrëdhënia e kësaj Organizate me Sindikatën, jo vetëm me një Sindikatë siç ishte normuar në ligjin e mëparshëm. Nisur nga ky ndryshim thelbësor, me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Drejtori i Financave, më datë 21.07.2014 u kërkoi të gjithave

njësitë shpenzuese në varësi të Policisë së Shtetit, moskryerjen e ndalesave për kuotizacionin që punonjësit të Policisë së Shtetit që i paguanin në masën 0.5% të pagës. Kjo masë bllokuese sipas policisë së shtetit, për këtë vendim është ankuar sindikata e cila e ka konsideruar shkelje të ligjit. Nga shqyrtimi i kësaj ankese, rezultoi se Kontrata Kolektive e Punës është lidhur ndërmjet Sindikatës dhe DPP-së sipas ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", neni 82, pikat 3 dhe 4 dhe neni 85, pika 3. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, rezultoi, se ajo është lidhur me një afat të pa përcaktuar (pa afat) dhe në nenin 8 të saj është parashikuar detyrimi i punëdhënësit (DPP-së), që të mbajë në fuqi këtë kontratë, shoqëruar me listën e nënshkruar prej anëtarëve, gjë e cila është paraqitur prej sindikatës dhe për mbështetur në këtë detyrim kontraktual, i duhen kaluar detyrimet e kuotizacionit të anëtarëve, në llogarinë bankare të sindikatës. Mirëpo policia nuk i kalon, madje i ka bllokuar në mënyrë antiligjore, jo se ashtu e ka bindjen dhe kuptimin ligjor në këtë rast, por si presion që sindikata të hesht, të mos kërkojë të drejtat e punonjësve të policisë së shtetit, të cilat janë shkëlqur, janë mohuar e nuk zbatohen. Në nenin 17 është parashikuar detyrimi i palëve, për të pasqyruar aktet ligjore e nënliligjore që lidhen me objektin e saj. Ndërkohë është parashikuar edhe rasti i pezullimit ose e pushimit para kohe të kësaj kontrate, por ajo është e kushtëzuar vetëm me marrëveshje midis palëve.



According to the leader of the Union of State Police Employees, Sadetin Fishta, they are the Special Forces and EAGLE Units which are affected by the addition to their salary

## Units that suffer are Special Forces, EAGLE Unit and RESI. The formula of seniority is changed Police salaries, Fishta: The decision lowers up to 15%

Approximately 2500 police employees of State Police are suffering a reduction of their salaries from 7% - 15% with the empowering of the new law. The most categories affected are those of the rank of Inspector.

According to the leader of the Union of State Police Employees, Sadetin Fishta, they are the Special Forces and EAGLE Units which are affected by the addition to their salary. The addition in their salaries with 20 thousand lek for a special nature, according to Fishta is 15 thousand lek. "Prior to this decision there is another one issued by the Government where the payments

for a special nature of their work is determined. If we will compare these two decisions we will notice a fluctuation as some police employees are affected by the last decision issued lately. Affected means that their salaries are lowered. It means that they will have a lower salary. The fluctuation goes from 9500 lek up to 4500 lek", Fishta noticed out.

Later, Fishta stressed out that another problem is the calculated salary according to job seniority because pursuant to this law the years before 1992 are not taken into consideration.

Payment for job seniority is determined by the law and it is pre-

sent into the law 'For State Police' since the police employee starts its carrier. What happen with the implementation of this decision? Police employees are paid since 1992 when the application of the ranks has started and the other years are not taken into consideration for job seniority. This means that the State Police has started in 1992 and before this year there was no State Police at all ... But there is a great number of police employees which have started work before 1990" noticed Fishta. Also, he explains that the formula of calculation has changed in another aspect as well. Before, the police employees were

paid for job seniority by calculating the percentage with the salary per actual rank that they enjoyed, starting from 2008 and today. It was calculated 1% per each working year. So, police employees were paid 9% of the basic payment per rank. While with the new formula police employees take 1% per each working year since 1992, but not based on the basic payment per their rank. So the calculation is at the ratio of 1% for the lower rank inside State Police that is the rank of Inspector. The leader of Police Union announced that the Union will follow all the court steps including the Strasbourg Court as well.

## Senior police leaders do not want unionism

CESP declaration after Tirana meeting: Respect the Contract or we will address to Strasbourg

The blocking of the Police Union by the State Police for more than three years forced the leaders of CESP to pay a visit to Tirana and organize a meeting with the leaders of State Police. The meeting was organized at the beginning of March. During a hard discussion it was obviously clear that the leaders of State Police lack the will to support the unionism and respecting the Collective Agreement signed in 2009, by presenting new conditions. CESP declares that they will follow legal attempts up to Strasbourg Court. This meeting was attended by the representatives of the Ombudsman, who gave their recommendations to solve this hard discussion but their recommendation were not taken into consideration by the representatives of State Police. The hard discussion lasted for more than one hour was focused on three main pillars, that are, leaving the offices according to the Collective Agreement, job dismissal or transferring of some local union leaders without prior consultations with the Union and blocking of the membership fee to the bank account of the Union in the time when this social obligation is accepted by signing the individual declarations, where the police employee accepts with his own free will to be a member of the Union. This was the hardest topic as the Police does not accept to keep the membership fee despite the free will of the police employees. The question if it was possible to come to a solution for this topic, the representatives of the Directorate of State Police answered that they had to address to their senior leaders, though there is a contract between parts, a contract which is not respected from the General Directorate of State Police. This meeting was attended by the President of CESP, Mr. Andreas SYMEOU, Secretary General of CESP, Mr. Geert

PRIEM and other members of the Executive Bureau of CESP, chairman of Albanian Police Union, Mr. Sadetin FISHTA and representatives of Kosovo Police Union. Under such conditions we are publishing the discussion between parts. After opening of this meeting the first who took the floor and spoke about the clash between the Union and Police was the Director of Juridical Directorate who addressed his opinion regarding this hard topic.

About this meeting in Tirana, CESP, had a press release, stressing out their deep disappointment to the actual police leaders. In their



official link, CESP, published their declaration where they explains that the meeting was held in Tirana aiming to support Albanian Police Union in order to solve the problems with the general Directorate of State Police and Ministry of Interior.

"After a hard discussion it was obviously clear that Police Directorate did not want to support Unionism and they had not the will to

go on with the procedure agreed on Collective Agreement in power regarding collection of the membership fee to the bank account of the Union though they got a clear message by CESP representatives that the late one, CESP, was ready to present a collective claim to European Court of Strasbourg" – it is said in the CESP declaration and goes on that the President and Sec-

retary General of CESP asked from the representatives of General Directorate to make possible the existence of constructive social dialogue between the Union and the Government. On March 4, CESP and Albanian Police Union held a press conference in the presence of some Albanian TV stations where the informed about the situation in our country.

### The Contract

After meeting with CESP, Union addresses a request to leader of Police, Mr. Haki CAKO

## Executive Chairmanship: 4 infringements of Police Directorate towards the employees

After meeting with CESP, Albanian Police Union organized a meeting of General Assembly informing them for the blocking that police is doing to its syndical activity. In this meeting it was noticed out that the Union is going on with its attempts to negotiate with the leaders of State Police and Ministry of Interior in an institutional way to fulfill its obligations based on the Statute and Collective Working Agreement in power. After that meeting the leader of the Union held a press conference explaining that the fact of violating the rights of Police, foreseen in the Collective and Individual Working Contract have been constant from the leading staff of state Police and recommendations of the Union are not taken into consideration, thus forcing the Union making use the legal means and presenting such violations to CESP, which we are member since 2010. Po-

lice Union stressed out some of the flagrant cases of the violation of the rights such as, fighting the Union by expelling it from the offices through the written illegal orders of the General Directorate of State Police and blocking of the membership fee aiming to denigrate and lower the reputation and damaging all the central and local structures of the Union by transferring and expelling its leaders all over the country. Also, a hard violation is considered the collective expelling from the police ranks of the police employees without consulting with the Union using different motivations which do not have any legal basis at all. This is proved by the great number of police employees, 500, through court decisions who have won the right of being paid by 9-12 salaries. Today none of Police leaders is not responsible for such illegal orders. It was also mentioned in that press conference the lower from salary

with 5500 – 9500 lek of more than 2000 police employees due to the disestablishing of the rank of Chief Inspector, also non issuing in time by the Government of the sublegal acts thus blocking the legal benefits for; supplementary pension and service; 25% of the salary for senior service; a free meal by the state; life insurance for all police employees and free housing treatment for familiars of the police employees being dead on duty.

"Under such conditions, the police employee is "protected" only by the leaders of Police, who are responsible for all above mentioned acts. Police Union, being part of the European Police Union, has asked by all the Union members of CESP and other representatives in European Council support to change such situation into the favor of the police employees"- declares the Executive Chairmanship of the Albanian Police Union.

### DECISION

## The Court: Working Contract is in power

Administrative Court of first step, in Tirana has decided on empowering the Working Collective Contract between the Union and Police Directorate and the obligation of the late part to release the membership fee blocked since 2014 up to now. The decision is taken in April after a long odyssey, where the Union asked the obligation of the Directorate of Police to implement the Working Collective Contract, nr.1966, date 03.04.2009, bended between Albanian Police Union and the respondent party. This blocking was named as a pressure against the social rights of police employees. According to article 2 of this Contract, it results that it is bended without a time limit and in article 8 of this Contract is foreseen the obligation of the Employer (General Directorate of Police) to keep this Contract into power, accompanied with the list signed by the members, which is presented by the Union to support this contractual obligation, so the membership fee has to be canalized into the Union bank account.